

UDHËZIM
Nr. 4, datë 28.2.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 25.11.2010 “MBI KËRKESAT
SPECIFIKE TË HIGJENËS DHE KONTROLLET ZYRTARE PËR PRODUKTET
ME ORIGJINË SHTAZORE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 23, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në kreun II. A, pika 1, germa “b”, e udhëzimit nr. 21, datë 25.11.2010 “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore”, ndryshohet si më poshtë:

“Vezët magazinohen dhe transportohen deri në shitjen te konsumatori përfundimtar në një temperaturë që preferohet të jetë konstante, në mënyrë që të sigurojë ruajtjen optimale të vetive higjienike të tyre. Vezët e freskëta duhet të ruhen dhe transportohen në një temperaturë jo më pak se +5°C. Vezët magazinohen në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të arritshme për ekzaminim. Ekzaminimi i vezëve të kryhet gjatë dhe pas magazinimit. Mbahen të dhëna ekzaminimi, në mënyrë që të kontrollohet data e depozitimit të vezëve dhe data e shpërndarjes”.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**
Bledar Çuçi